

BUXHETI 2020



Buxheti i shtetit për vitin 2020 u miratua nen për nen dhe në tërësi nga Kuvendi i Shqipërisë. Në fjalën e saj gjatë seancës plenare, Ministria Denaj u shpreh se Buxheti 2020 është Buxheti i rimëkëmbjes dhe vazhdimësisë së konsolidimit fiskal. Fondi për Rindërtimin, për përbalimin e situatës së krijuar pas tërmetit të datës 26 nëntor, do të jetë 20 miliardë lekë, ku 13 miliardë lekë financohen nga Buxheti dhe 7 miliardë lekë nga donatorët. Paralelisht, Buxheti mbron parametrat makroekonomikë dhe fiskalë për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe vijimin e konsolidit fiskal, duke synuar një rritje ekonomike prej 4.1% për vitin 2020.

PAKETA FISKALE 2020



Paketa Fiskale për vitin e ardhshëm mori miratimin përfundimtar nga Kuvendi i Shqipërisë. Një prej incentivave kryesore që sjell Paketa Fiskale është ajo për sektorin e industrisë automotivë, ku ulet tatim fitimi nga 15% në 5%. Po ashtu, përjashtohet nga tatimi kalimi i pronësisë, për banesat dhe truallin, në rast se dhurimi ndodh brenda trungut familjar, nga prindi te fëmija. Paketa parashikon edhe përjashtimin nga TVSH për importimin e shtëpive të gatshme, materialeve, komponentëve dhe pajisjeve që do sillen për ndërtimin e banesave (tulla, beton, hekur etj.) dhe që do të gjenden në situacionimin e punimeve, në kuadër të Programit të Rindërtimit.

REFORMA E FISKALIZIMIT




Ligji "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i njohur ndryshe si ligji i Fiskalizimit, do të hyjë në fuqi në datën 1 janar 2020 dhe do të nisë të zbatohet në datën 1 shtator 2020. Periudha tranzitore e parashikuar deri në nisjen e zbatimit të tij do t'i shërbejë bizneseve për tu informuar dhe përgatitur mbi detyrimet që ata duhet të përmbushin, sipas parashikimeve ligjore. Në fjalën e saj gjatë seancës plenare ku u miratua ligji, Ministria e Financave dhe Ekonomisë tha se Fiskalizimi synon të ndikojë jo vetëm në rritjen e të ardhurave, por në mirëadministrimin dhe reduktimin e ekonomisë informale.

CEFTA WEEK 2019



Shqipëria mbylli me sukses kryesimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë në Europën Qendrore-CEFTA, që u finalizua me organizimin e eventit "CEFTA Week 2019" gjatë të cilit u zhvilluan një sërë aktivitetesh. Në aktivitetet ku morën pjesë përfaqësues të qeverive të vendeve të CEFTA-s, dhomat e tregtisë të rajonit dhe përfaqësues nga Komisioni Europian, u theksua rëndësia e forcimit të bashkëpunimit dhe dialogut konstruktiv mes vendeve dhe bizneseve të rajonit. Disa dokumente të rëndësishme u miratuan nga Komiteti i CEFTA-s, të cilat synojnë lehtësimin e tregtisë mes vendeve të rajonit dhe reduktimin e barrierave, një prej të cilëve është Protokollin shtesë 6 për tregtinë e shërbimeve.

NDËRTIMI I AEROPORTIT TË VLORËS



Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, mori pjesë në ceremoninë e hapjes së garës ndërkombëtare për projektin e ndërtimit të aeroportit të Vlorës. Në fjalën e saj të rastit, Ministria Denaj vlerësoi efektin pozitiv që do të ketë për ekonominë ndërtimi i aeroportit të Vlorës, si rritja e ekonomisë dhe punësimit në këtë zonë, si dhe ndikimi në tërheqjen e investimeve. Projekti i ndërtimit të Aeroportit të Vlorës do të jetë një koncesion i formës BOT (Ndërto, Opero-Transfero) me një afat 35 vjeçar. Tenderi i hapur ndërkombëtar për Aeroportin e Vlorës do të mbyllet me 12 Mars të vitit të ardhshëm.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE



Investimeve e Huaja Direkte janë 810 milionë euro për 9-mujorin e vitit 2019, 7.3% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Gjatë pjesëmarrjes së saj në konferencën e OECD dhe UCCIAL mbi potencialin e rritjes së vendeve të Ballkanit Perëndimor, Ministria Denaj vuri theksin në masat që janë ndërmarrë në lehtësimin e të bërit biznes dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Ministria u shpreh se qeveria është e angazhuar në tërheqjen e investimeve të huaja përmes reformës së deregulimit, ligjit të ri të investimeve, lehtësive fiskale dhe investimit në burimet njerëzore.

BASHKËPUNIMI EKONOMIK SHQIPËRI-TURQI



Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, priti në një takim kryetarit e Dhomës së Tregtisë së Turqisë, Rifat Hisarcikloglu dhe një grup biznesmenësh turq. Gjatë këtij takimi, Ministria Denaj njohu bashkëbiseduesit me objektivat e qeverisë shqiptare në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit dhe potencialit ekonomik që ofron Shqipëria për investitorët e huaj, duke përmendur sektorët e ekonomisë që mund të jenë me interes për biznesin turk. Thellimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me Turqinë si një partner kyç, jo vetëm në fushën e tregtisë, do të vijojë duke u intensifikuar dhe më tej përgjatë vitit 2020.